



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË NË KATEGORINË  
E MESME DREJTUESE**

Lloji i diplomës "Shkenca juridike"

niveli minimal i diplomës "Master Shkencor"

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për plotësimin e vendit të lire të kategorisë së mesme drejtuese, për pozicionin:

**• 1 (një) Drejtor në Drejtorinë e Integrimit dhe Legjislacionit Ndërkombëtar - Kategoria II-1.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJE PARALELE: 08.08.2023.

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR NGRITJE NË DETYRË: 14.08.2023.

**Përshkrimi i punës:**

Detyrat dhe përgjegjësitetë kryesore:

- Shpërndan dhe ndjek detyrat specifike në përbushjen e detyrimeve të institucionit që lidhen në procesin e integrimit dhe veçanërisht me plotësimin e kritereve për anëtarësimin në Bashkimin Europian.
- Urdhëron dhe ndjek zbatimin e akteve që miratohen në kuadër të organizmave evropiane ku Shqipëria është palë apo synon të anëtarësohet;
- Drejton në përgatitjen e projekt-akteve, projekt-rregulloreve dhe projekt-udhëzimeve dhe dhënie mendimi për akte të ndryshme ligjore (projekt ligje dhe projekt vendime) në kuadër të përafrimit të legjislacionit.

## I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### I.1- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria II-1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurredim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë eksperiencë pune në nivel të mesëm drejtues;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.
- Të jetë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

### I.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 08.08.2023.

### I.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 08.08.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

#### **I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësítë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.43/2016, “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri në lidhje me procesin e integrimit evropian;

#### **I.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pike), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi bazën ligjore të sipërcituar, si dhe njohuritë, aftësitë, kompetencat mbi përshkrimin e pozicionit të punës, përvojën në punë, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

#### **I.6- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

### **II- Ngritja në detyrë**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

#### **II.1-Kërkesat e përgjithshme**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;

- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.
- Të jetë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

#### **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për Shkenca Juridike”
- b) Të kenë mbi 1 vjet përvojë pune në pozicione të kategorisë e ulët drejtuese në fushën përkatëse;
- c) Të ketë aftësi për të ofruar drejtim profesional, për të planifikuar, koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dispozicion.
- ç) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

#### **II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim në vandin e punës që konkurron;
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

#### **II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:**

Pas datës 14.08.2023 njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes ne detyrë si dhe datën, vandin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta të ngritjes në detyrë do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

## **II.4- Fusha e njohurive, ku do të vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitet janë:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Njohuri në lidhje me ligjin nr.43/2016, “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;
- Njohuri në lidhje me procesin e integrimit evropian;

Kandidatët në intervistën e strukturuar me gojë do të vlerësohen, në lidhje me njohuritë mbi; bazën ligjore të sipërcituar, si dhe njohuritë, aftësitë, kompetencat mbi përshkrimin e pozicionit të punës, përvojën në punë, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

## **II.5 - Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë deri në 40 pikë;
- Dokumentacioni i dorëzuar deri në 20 pikë

## **II.6 - Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të AMA-s dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë